

ROMANI HISTORIK SHQIPTAR NË KONTEKSTIN E LETËRSISË EUROPIANE

Valbona KALO¹

¹ University "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

*Corresponding author e-mail: valbona.kalo@uniel.edu.al

Abstract

The Albanian historical novel, although rooted in the tradition of the European genre, is distinguished by its distinct attributes that reflect the depth of the cultural and historical context of Albania. This study aims to explore how historical and political factors have influenced the formation and evolution of this genre in Albanian literature, beginning with "Shkodra e rrethuemë" by Ndoc Nikaj in 1913, recognized as the first work in this genre. Specifically, the analysis will focus on contemporary novels such as "Selvitë e Tivarit" by Mehmet Kraja and "Të jetosh në ishull" by Ben Blushi, which, despite similarities with the European historical novel, exhibit a modern treatment of historical themes and contribute to the genre's development.

The methodology employed includes a comparative analysis of representative works from the European and Albanian historical genres, focusing on how fiction and historical reality intertwine, as well as on the treatment of characters and events that have shaped national identity. Through a comparative approach, the study aims to identify not only commonalities but also the distinctive features that differentiate the Albanian historical novel within the broader context of European literature.

Keywords: Historical novel, Albanian literature, modern changes, European influence, national identity.

Përmbledhje

Romani historik i letërsisë shqipe, edhe pse rrjedh nga tradita e zhanrit evropian, dallohet për atributet e tij të veçanta që reflektojnë thellësinë e kontekstit kulturor dhe historik shqiptar. Ky studim propozon të hulumtojë se si faktorët historikë dhe politikë kanë influencuar formësimin dhe evoluimin e këtij zhanri në letërsinë shqipe, duke filluar me "Shkodra e rrethuemë" e Ndoc Nikajt (1913), si vepra e parë e këtij zhanri. Në veçanti, analiza do të përqendrohet në romanet moderne dhe bashkëkohore, të cilat, përkundër ngjashmërive me romanin historik evropian, shfaqin një trajtim origjinal të temave historike dhe kontribuojnë në zhvillimin e zhanrit.

Metodologjia e përdorur përfshin një analizë krahasuese mes veprave të zhanrit historik evropian dhe atyre shqiptar, duke u fokusuar në mënyrat se si trillimi dhe realiteti historik ndërthuren, si dhe në trajtimin e personazheve dhe ngjarjeve që kanë ndikuar në formësimin e identitetit kombëtar. Përmes qasjes krahasuese, studimi synon të identifikojë jo vetëm përbashkësitë, por edhe veçoritë që e dallojnë romanin historik shqiptar në peizazhin e letërsisë evropiane.

Fjalë kyçe: romani historik, letërsia shqipe, ndryshime moderne, influenca evropiane, identitet kombëtar.

Hyrje

Romani historik ka qenë gjithmonë një zhanër vital në letërsinë europiane, duke u shfaqur si një mjet për të eksploruar dhe rikujtuar ngjarjet e mëdha historike përmes një lenteje artistike dhe narrative. Sipas G. Lukács, ky zhanër u shfaq “si një formë artistike që shërben për të kuptuar të kaluarën, duke reflektuar konfliktet dhe luftërat e mëdha sociale” (Lukács, 1983: 39). Ndërsa tradita europiane është e gjatë dhe e pasur, karakterizuar nga veprat e autorëve përrues të romanit historik si Walter Scott dhe Alessandro Manzoni, letërsia shqiptare e dëshmon fillimin dhe zhvillimin e zhanrit rreth një shekull më vonë në një kontekst të ndërlikuar historik dhe politik.

Ky fillim i vonuar i romanit historik në letërsinë shqiptare, në krahasim me vendet europiane, pasqyron një veçanti të përvojës letrare në Ballkan, ku zhvillimi i zhanrit dëshmohej pas fitimit të pavarësisë kombëtare nga popujt ballkanikë. Në kontekstin shqiptar, ku historia dhe politika janë të ndërthurura ngushtë, romani historik merr një dimension të rëndësishëm të veçantë. Ai ka shërbyer jo vetëm si një mjet për të dëshmuar, kujtuar dhe interpretuar historinë apo si “një provë e ekzistencës kombëtare” por edhe si një “formë e rezistencës dhe rindezjes kulturore” në një vend që ka përjetuar ndryshime të shpejta politike dhe sociale (Krasniqi, 1985: 23).

Ndoc Nikaj, në veprën e tij “Shkodra e rrethuar” (1913), paraqet një nga përpjekjet e para për të kombinuar historinë me narrativën letrare në kontekstin shqiptar, duke paraqitur një dëshmi të hershme të përpjekjes për formësimin e identitetit kombëtar përmes letërsisë. Ky studim synon të eksplorojë zhvillimin dhe evoluimin e romanit historik në letërsinë shqipe, përmes një qasjeje krahasuese me modelet zhanrore europiane, për të nxjerrë në pah jo vetëm ndikimet e përbashkëta, por edhe veçoritë unike që dallojnë romanet shqiptare.

Përmes një analize të thellë të teksteve të zgjedhura, artikulli do të shqyrtojë se si autorët shqiptarë kanë përdorur zhanrin historik për të trajtuar çështje të kujtesës, identitetit dhe ndikimit të politikës në narrativat kombëtare, duke u bazuar në veprat e autorëve të njohur si Skënder Drini, Bilal Xhaferri, Zejnulla Rrahmani, Ismail Kadare, Mehmet Kraja dhe të tjerë. Veprat e këtyre autorëve përfaqësojnë arritjen më të mirë të prozës historike shqipe, si dhe përpjekjet për evoluimin cilësor të zhanrit, përmes një rrëfimi që priret nga simboli dhe alegoria, si dhe përdorimit të një sërë përftesave moderne dhe postmoderne.

Rishikimi i literaturës dhe metodologjia

Studimi “Poetika e romanit historik shqiptar” nga Bajram Krasniqi konsiderohet një burim thelbësor për të kuptuar specifikat dhe zhvillimin e romanit historik në letërsinë shqiptare. Vepra “The Historical Novel” (Romani historik) e Georg Lukács ofron një perspektivë formaliste për zhanrin historik, ndërsa studiues si Jeremy De Groot, Brian Hammet dhe Linda Hutcheon kanë pasuruar diskursin duke shtuar koncepte si metafiksioni dhe narrativa postmoderne, të cilat sfidojnë mënyrat tradicionale të rrëfimit historik.

Elisabeth Wesseling, në veçanti, në veprën e saj “Writing History as a Prophet: Postmodernist Innovations of the Historical Novel” (Të shkruash historinë si profet: Inovacionet postmoderne të romanit historik), argumenton për një linjë vazhdimësie midis romanit historik tradicional dhe formave të reja postmoderne që sfidojnë dhe zgjerohen mbi mënyrat tradicionale të rrëfimit historik. Këto studime na ndihmojnë të kuptojmë se si romanet historike mund të funksionojnë si një mjet për të sfiduar dhe rinegociuar kuptimet e historisë dhe të identitetit në kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Ky studim përdor metodat krahasuese dhe analitike për të hulumtuar ndikimet dhe ndërveprimet ndërkulturore dhe politike në evoluimin e romanit historik shqiptar në krahasim me atë europian.

Analiza do të fokusohet në trajtimin e historisë, karakterizimin e personazheve dhe përdorimin e fiksonit dhe faktit në romane historike ndikuese shqiptare dhe ato europiane me ngjashmëri tematike dhe stilistike. Studimi do të mbështetet në teori letrare dhe historike për të lidhur gjetjet me diskursin akademik mbi romanin historik, duke konkluduar me një sintezë të temave kryesore dhe rolin e romanit historik shqiptar në kontekstin letrar dhe më gjerë.

1. Sintetizimi i traditave dhe risive në romanin historik shqiptar: ndikimet klasike dhe realiste

1.1. Ndikimi i modeleve klasike: Romani historik shqiptar nisi të zhvillohet në fillim të shekullit të 20-të, një periudhë e shënuar nga ndikimi i thellë i modeleve të romanit historik europian. Veçanërisht të rëndësishme do të ishin në këtë drejtim kontributet e Walter Scott dhe Alessandro Manzoni, të cilët konsiderohen si “figurat më ndikuese në formimin e këtij zhanri në letërsinë europiane” (Hamnet, 2011:74-75). Kjo pjesë e analizës synon të shqyrtojë mënyrën se si ndikimet e këtyre dy autorëve ndërtuan themelin e parë të zhanrit historik në kontekstin shqiptar përmes veprave të para që demonstrojnë një sintezë të elementeve narrative dhe tematike europiane me realitetet dhe aspiratat shqiptare.

Ndikimi i Scott-it dhe Manzoni në letërsinë shqipe shfaqet qartë në përdorimin e historisë si sfond për të ndërtuar intriga të ndërlikuara që lidhin çështjet e identitetit kombëtar me luftën për liri dhe dashurinë romantike. Në veçanti, vepra “Shkodra e rrethimeve” e Ndoc Nikajt, e cila u botua në vitin 1913, e dëshmon këtë sintezë, duke përfshirë elemente të romantizmit dhe heroizmit që janë tipike për romanet e Scott-it, si dhe një thellësi psikologjike dhe moralizuese që reflekton ndikimin e Manzoni.

Në veprat e Ndoc Nikajt, ndikimi i modelit skotjan të Walter Scott vihet re në mënyrën e ndërtimit të personazheve heroikë si Ndoci të “Shkodra e rrethimeve” dhe Dhimitri të “Lulja e kujtimit”. Këta personazhe përfaqësojnë frymën heroike dhe pasionin për atdheun, të lidhur ngushtë me traditat dhe shfaqen si mbrojtës të vlerave kombëtare. Për shembull, Ndoci thotë: “Nesër për të t’erun të natës më duhet me dalë prej Shkodre, i lidhur me besë shqiptare ndo me mujtë, ndo me dekë për liri... Unë po baj fli jetën për Shqypni, ti ban zemrën.” (Nikaj, 1961: 96).

Sipas Alexander Welsh, modeli skotjan përfshin “përdorimin e figurave historike si personazhe të dorës së dytë që shtojnë autenticitetin e rrëfimit pa marrë role kyçe në intriga”, një praktikë e evidentuar në veprat e Nikajt (Welsh, 1962: 62). Përjashtimet e këtij modeli janë veçanërisht të qarta në vepra të tjera shqiptare si “Kthimi i Skënderbeut në Krujë” dhe “I fundmi i Kastriotëve”, ku figura historike marrin role më të rëndësishme. Përkundrazi, në veprat e Nikajt, Postolit dhe Harapit personazhet qendrore nuk përfaqësohen si figura heroike tradicionale me tipare të jashtëzakonshme por si “heronj mesatarë” që bëhen jashtëzakonisht të rëndësishëm në kontekstin e ngjarjeve historike dhe sociale, “përmes veprimeve dhe vendimeve të tyre” (Welsh, 1962: 65).

Pavarësisht nga pikat e përbashkëta të theksuara më lart, veprën e Nikajt si përfaqësuesi kryesor i këtij modeli, në krahasim me modelin historik të Scott-it e karakterizojnë një sërë kufizimesh cilësore, ku një nga më kryesorët është ai i mungesës së “paraqitjes së personazheve me jetën e tyre të vërtetë mendore, intelektuale”, si dhe mungesa e “karakterizimit psikologjik” (Wesseling, 1991:47). Historia, në veprat e Nikajt, Postolit dhe Harapit, përfaqëson më shumë një repertor emrash dhe shembëlltyrash historike, dhe vlera artistike e romaneve qëndron tek “fabula interesante dhe plot peripeci, ku personazhet përjetojnë aventura të ndryshme” dhe në fund takohen, martohen dhe i edukojnë fëmijët me frymë patriotike: “Bardhia e Shpendi u plakën në dashtnii të shoqishoit, rritën fëmijët në hiir në Tenzont e në dashtunie të komshiis...” (Nikaj, 1918:126)

Analiza e ndikimeve të modeleve të Scott dhe Manzoni në romanin historik shqiptar tregon një përparësi të qartë të modelit manzonian, veçanërisht në prozën e autorëve si Ndoc Nikaj dhe Harapi. Ky ndikim i Manzoni është rezultat i një “lidhje të drejtpërdrejtë që këta prozatorë klerikë kishin me shkollën letrare italiane”, e cila u mundësoi atyre njohje të thella me veprat “përmes leximeve dhe përkthimeve në gjuhën përkatëse” (Kola, 1997:77) Veçanërisht, romanet si “Fejesa në djep” e Nikajt dhe “Pushka e tradhëtarit” e Harapit e tregojnë një ndikim të tillë nga vepra “*I promessi sposi*” (Të fejuarit) e Manzoni, ku elemente të tilla si atmosfera, fryma fetare kristiane dhe psikologjia e personazheve që karakterizohen nga besimi i madh tek Zoti, janë mëse të dukshme.

Këto vepra shfaqin një sërë përbashkësish edhe në veprimet dhe motivimin e personazheve, si dhe në strukturën e rrëfimit, ku ata përjetojnë ndarje dhe peripeci të ngjashme me ato të Renzo dhe Lucias në veprën e Manzoni. Kjo sintezë e elementeve narrative dhe tematike europiane me realitetet dhe aspiratat shqiptare në krijimet e Nikajt dhe autorëve të tjerë reflekton një adaptim të modeleve klasike europiane në kontekstin shqiptar, duke kontribuar në formimin dhe zhvillimin e zhanrit të romanit historik në letërsinë shqipe. Këto vepra, duke përdorur modele të njohura dhe të pranura nga letërsia europiane, kanë arritur të krijojnë një “narrativë gjithnjë e më të vetëdijshme mbi bazën e ndryshimeve shoqërore të mëvonshme” që është thellësisht e lidhur me kontekstin kulturor dhe historik shqiptar (Qosja, 1973: 99).

1.2. Ndikimi i modeleve realiste: Realizmi në romanin historik shqiptar ka sjellë një thellim të trajtimit të temave historike dhe shoqërore, duke reflektuar ndikimet e shkrimtarëve europianë të këtij drejtimi, si C. Dickens, H. de Balzac, dhe L. Tolstoi. Autorët shqiptarë Sterjo Spasse, Thoma Kacorri, Haki Petrela, Skënder Drini etj., kanë adoptuar një qasje më të gjerë dhe të thellë në përshkrimin e epokave që trajtojnë. Sterjo Spasse në veprat e tij, dhe veçanërisht në ciklin “Rilindasit”, përdor teknikën e çmitizimit të personazheve historike, duke i paraqitur në një kontekst më të gjerë shoqëror, politik dhe kulturor. Kjo metodë pasqyron ndikimin e thellë të modelit realist të Tolstoit, siç thekson Bajram Krasniqi, ku Spasse synon të ofrojë “një panoramë të gjërë të shoqërisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare” (Krasniqi, 1985: 99).

Nga ana tjetër, në romanin “Vraje tradhëtinë” të Skënder Drinit, qendrën e skenës e zënë personazhet fiktive sipas stilit të Scott-it, ku heronjtë fiktivë si Braho Shkreli dhe Kol Idromeno, përfshihen në veprime heroike si përgjigje ndaj thirrjeve të historisë. Personazhet historikë si Riza Pashai dhe Esat Pasha paraqiten si figura të dorës së dytë, duke theksuar ngjashmëritë me persona realë dhe duke shtuar thellësinë dhe origjinalitetin në portretizimin e tyre. Në përgjithësi, teknika narrative e Spasses dhe e Skënder Drinit përdor historinë si sfond për të zhvilluar personazhet dhe rrëfyer ngjarje me ndikim të qartë realist. Romani “Vraje tradhëtinë” trajton lëvizjet historike me realizëm të theksuar, ku trillimi dhe faktet historike ndërthuren për të forcuar idealin dhe për të sjellë një përfaqësim më të besueshëm të personazheve historikë.

Përdorimi i realizmit në romanet historike shqiptare bën të mundur gjithashtu rifunksionalizimin e historisë si mjet për të adresuar dhe kritikuar çështjet sociale dhe politike aktuale. Studiuesi B. Kuçuku thekson se ky model romani jo vetëm që rikthen ngjarjet e mëparshme, por ofron gjithashtu një platformë “për të shqyrtuar dhe vlerësuar zgjedhjet e bëra gjatë atyre periudhave dhe pasojat e tyre në kontekstin bashkëkohor”, duke reflektuar njëherësh një “vetëdije historike moderne dhe patriotike” (Kuçuku, 2010a).

Ndikimi i modeleve realiste ka bërë të mundur për autorët shqiptarë të zgjerojnë kufijtë e romanit historik, duke e transformuar atë në një fushë të begatë për eksplorimin e të vërtetave historike dhe sociale në mënyrë më të thellë dhe të reflektuar. Sipas Auerbach, themelet e realizmit modern ngrihen përmes “trajtimit serioz të realitetit të përditshëm dhe ngritjes së klasave të gjera dhe inferiore të shoqërisë në objekte të një përfaqësimi problematik-ekzistencial”, si dhe përmes përfshirjes së njerëzve dhe ngjarjeve të çdo lloji në “damarin e

historisë bashkëkohore” (Auerbach, 2000: 269). Kjo qasje ka kontribuar në formimin e një tradite narrative që është e lidhur ngushtë me realitetet historike dhe angazhuese në diskutimet mbi vlerat dhe sfidat e kohës.

2. Transformimi dhe postmodernizmi në romanin historik shqiptar: rishikimi i historisë dhe prirjet e reja

2.1. Modernizmi në romanin historik shqiptar: Romani historik modern shqiptar, të cilin e përfaqësojnë autorë si Ismail Kadare, Bilal Xhaferi, dhe Jusuf Buxhovi, ka ndryshuar trajtimin e historisë nga një rrëfim thjesht kronologjik në një platformë për refleksion të thellë dhe kritikë. Ky zhanër integron teknika narrative moderne që pasurojnë zhvillimin e temave dhe karaktereve. Në veprën “Kështjella” të Ismail Kadaresë, historia nuk është thjesht sfond, por bëhet mjet për të adresuar çështje të rëndësishme të kohës.

Kadare, duke ndjekur “modelin e famshëm historik të Flaubert” me veprën “Salammbô”, i qaset historisë nga “një optikë e epërme” duke e përdorur si mjet “për të ndërhyrë dhe kuptuar realitetin social dhe politik të kohës në të cilën shkruhet vepra” (Kadare, 2002: 82-83; De Groot, 2010: 46). Kjo metodë hap rrugën për një analizë të thellë të motivimeve historike dhe të pasojave të tyre në kontekstin e kohës së shkrimit, duke i dhënë veprës një përmasë të re rëndësie dhe aktualiteti. Duke i vendosur ngjarjet në të njëjtën periudhë historike si te romani “Kështjella”, Bilal Xhaferi te “Krastakraus” dëshmon një përzierje të gjedhes realiste dhe romantike për të ndërtuar një rrëfim që integron ngjarjet e kohës së Skënderbeut me dilemat dhe konfliktet shoqërore e psikologjike të personazheve.

Ai integron elemente të modelit klasik skotian dhe manzonian, duke krijuar personazhe heroike të tipit “mesëm” si Leka Balsha, Martin Urbin, dhe Strez Piroli, të cilët janë të lirë në mendimet e tyre dhe të thellë në përvojat e tyre emocionale. Këto personazhe e bëjnë lexuesin të ndjejë lidhje me të shkuarën dhe të zbulojë kuptimet historike dhe letrare përmes narrativave që rrjedhin nga logjika e tekstit dhe kontekstit, “duke përfshirë tema të rëndësishme si Etnia dhe Liria” (Kuçuku, 2010b: 17). Vepra gjithashtu shquhet gjithashtu për mënyrën se si shndërron skenën në një element thelbësor të veprimit dhe shprehjen e hapësirës përmes konceptit të alegorisë moderne.

Xhaferi përdor edhe teknika të narrativës moderne, të ngjashme me ato të Flaubert, Tolstoi-t dhe Stendhal-it, duke iu ofruar lexuesve mundësi për refleksione historike, estetike dhe filozofike. Ky qëndrim i ri ndaj historisë në letërsi jo vetëm që e transformon romanin historik në një fushë studimi, por edhe si një nxitje për dialog dhe kritikë të thellë shoqërore. Te romani “Sheshi i Unazës” (1978) i Zejnullah Rrahmanit, ekzistenca historike zhvillohet në një strukturë kompozicionale rrethore, ku kohëzgjatja historike ringjallet, zbehet deri në zhdukje, dhe rilind në një cikël të përtëritjes dhe vazhdimësisë.

Vepra shquhet për ndërthurjen e veprimeve të brendshme me ato të jashtme, të shprehura përmes dy linjave narrative: njëra me karakter alegorik dhe tjetra që sjell përshkrimet më realiste të qytetit dhe ngjarjeve dramatike. Këto dy linja bashkohen në një nëntekst domethënës. Romanin e Rrahmanit e karakterizon përdorimi i analogjive të formës së zhanrit klasik, dhe një qasje dramatike në përballjen me temën e qëndresës, e cila ka qenë prezente në letërsi që nga mesjeta.

Pavarësisht përdorimit të elementëve modernë si simbolizmi, subjektivizmi, intertekstualiteti dhe ndërthurja e diskurseve, autori i mbetet besnik gjedhes klasike të zhanrit historik, duke integruar teknika si parateksti dhe oraliteti për të shtuar besueshmërinë e fakteve historike, në një “reflektim të thellë mbi obsesionin e Kosovës për liri, siç paraqitet në ringjalljen e një qytet-shteti” (Elsie, 1991). Modernizimi i romanit historik shqiptar shfaq një ndryshim të thellë në mënyrën e trajtimit të historisë, ku autorët e kësaj periudhe synojnë jo vetëm të paraqesin ngjarje historike, por të angazhohen aktivisht në një dialog me to.

Përmes këtij dialogu, ata diskutojnë, kritikojnë dhe ndonjëherë rishikojnë jo vetëm ngjarjet e kaluara, por edhe mënyrat në të cilat ato janë kuptuar dhe interpretuar. Ky angazhim ka çuar në krijimin e veprave të reja që shkojnë përtej të qenurit thjesht kronika; ato bëhen komente të gjalla mbi çështjet aktuale dhe sfidat shoqërore. Kështu, romani historik merr një rol të ri dhe të rëndësishëm në diskutimet kulturore dhe politike të kohës, duke pasuruar dhe zgjeruar perspektivën letrare dhe historike.

2.2. *Ndryshimi i perspektivës: Nga modernia në postmodernie në romanin historik shqiptar*: Qëndrimi ndaj historisë ka ndryshuar ndjeshëm nga epoka moderne në atë postmoderne. Nëse modernia trajton të kaluarën në mënyrë kritike, duke e shfrytëzuar si mjet për kundërshtim, postmodernia ofron një perspektivë të re, siç thekson U. Eco: “e kaluara nuk duhet shkatërruar, por duhet të rivizitohet me një qasje ironike për të shmangur heshtjen” (Eco, 2005: 474). Ky ndryshim i qëndrimit shihet qartë në evolucionin e romanit historik shqiptar, ku nga një perspektivë moderniste—në të cilën historia përdoret si sfond për të rrëfyer konfliktet me të tashmen—kalohet në një qasje postmoderne që përfshin të kaluarën në një dialog të vazhdueshëm me të tashmen.

Autorë si Mehmet Kraja, Mira Meksi dhe Ben Blushi kanë integruar në prozat e tyre elemente postmoderne që sfidojnë mënyrat tradicionale të trajtimit të historisë, duke mjegulluar kufijtë mes realitetit dhe imagjinatës si dhe mes perceptimit subjektiv dhe interpretimit objektiv të ngjarjeve historike. Përdorimi i teknikave si rivizitimi ironik i historisë, thyerja e kufijve zhanrorë, intertekstualiteti, metafiksioni, dependërimi dhe fragmentarizmi jo vetëm që ndërtojnë një strukturë komplekse narrative, por gjithashtu bëjnë që lexuesi të reflektojë si mbi natyrën e dijes historiografike ashtu edhe mbi vetë letërsinë.

Sipas L. Hutcheon postmodernizmi karakterizohet nga “metafiksioni historiografik”, një formë narrative që shfaq vetëdijen e të qenit konstruksion dhe “ngre dyshime rreth autoritetit të rrëfimeve historiografike” (Hutcheon, 1988: 29-30). Ky qëndrim ndaj historisë si një rrëfim që mund të rilexohet dhe të riformulohet për të krijuar kuptime të reja është i dukshëm edhe në veprat e autorëve të letërsisë shqipe. Në romanet “Moti i Madh” dhe “Netë Bizantine” të Mehmet Krajës, historia jo vetëm që shërben si sfond për rrëfimin, por gjithashtu merr një rol funksional në formësimin e një vizioni subjektiv të realitetit dhe ndërtimin e mitit që ndikon në perceptimin e lexuesve.

Eco shpjegon se “Askush nuk jeton në të tashmen e menjëhershme; të gjithë ne lidhim gjërat apo ngjarjet nëpërmjet funksionit ngjithës të kujtesës, qoftë ajo personale apo kolektive, histori apo mit” (Eco, 1997: 15). Kjo ide pasqyrohet në mënyrën se si historia përdoret në këto romane për të lidhur të tashmen me të shkuarën në një mënyrë që formon interpretimin dhe kuptimin. Ndërsa në romanin “Selvitë e Tivarit”, struktura narrative sfidon konceptin e linearitetit duke shpalosur një trajtim fragmentar dhe polifonik të historisë. Autori zgjeron përdorimin e intertekstualitetit dhe pastishit, duke e bërë dialogun me ngjarje dhe kontekste të ndryshme historike të së shkuarës një mjet për të aktivizuar formësimin e kuptimit dhe identitetit të së tashmes.

Postmodernizmi ka ndryshuar thelbësisht mënyrën se si trajtohet historia e gruas në prozën historike, duke sfiduar paragjykimet tradicionale dhe duke rivlerësuar përvojat e gruas. Veçanërisht, romanet e Mira Meksit “Frosina e Janinës” dhe “Mallkimi i Priftëreshave të Ilirisë” janë shembuj të ndikimit postmodern, që e zhvendosin fokusin nga kushtet materiale të jetës së gruas, në përfaqësimin e figurës së tyre nëpërmjet simbolizmit dhe diskursit. Sipas M. Maynard, këto lloj romanesh trajtojnë përvojën historike të gruas përmes një qasjeje që “integron tekstualitetin, strukturat materiale dhe marrëdhëniet sociale, duke ndriçuar mënyra të reja të kuptimit të identitetit gjinor dhe të vetëdijes historike” (Maynard, 1995, fq. 259). Duke përdorur elemente postmoderne, romanet e Meksit sfidojnë narrativat historike tradicionale dhe ofrojnë një perspektivë të re mbi studimin e historisë nga një këndvështrim femëror.

Studiuesi Adem Jakllari propozon një tipologji të re të romanit historik bashkëkohor, të quajtur “i kryqëzuar”, të cilën e sheh të përfaqësuar plotësisht në veprat e Ben Blushit, si “Të jetosh në ishull” dhe më pas “Otello Arapi i Vlorës” dhe “Shqipëria” (Jakllari, 2010). Në romanin “Të jetosh në ishull”, Blushi trajton përvojën e izolimit dhe të ndarjes nga konteksti historik dhe shoqëror në një mjedis ishullor. Autori adopton një qasje fragmentare, duke eksploruar mënyrat në të cilat kujtesa personale dhe historia kolektive mund të ndërthuren për të sfiduar narrativën historike mbizotëruese.

Ky proces reflekton mbi subjektivitetin dhe relativitetin e kujtesës dhe historisë, duke shfaqur një perspektivë të re në trajtimin e temave historike në letërsinë shqipe. Romanet e sipërpërmendura manifestojnë një qasje postmoderne që e bën të shkuarën pjesë të një dialogu të vazhdueshëm me të tashmen, duke i dhënë jetë një historie të gjallë dhe dinamike që është gjithmonë e hapur për rishikime dhe interpretime të reja. Ky ndryshim në letërsinë historike shqiptare pasqyron një maturim të ndërgjegjësimit letrar dhe një përqaftim të kompleksitetit të të kuptuarit dhe të përjetuarit historik.

Përfundim

Studimi i romanit historik shqiptar brenda kornizës së traditave letrare evropiane ka nxjerrë në pah disa teza kyçe. Së pari, është e qartë se edhe pse romanet historike shqiptare ndajnë elemente themelore me ato evropiane, ato përfshijnë në mënyrë unike nuancat historike dhe kulturore lokale që rezonojnë thellësisht me identitetin shqiptar. Këto romane nuk imitojnë thjesht stilet evropiane, por më tepër i përshtasin dhe i transformojnë ato për të eksploruar dhe shprehur tema dhe narrative specifike kombëtare.

Së dyti, ndikimi i ndryshimeve moderne në letërsi, si kalimi drejt teknikave narrative postmoderne përfshirë intertekstualitetin, metafiksionin dhe fragmentarizmin, është integruar efektivisht në romanin historik shqiptar. Këto teknika kanë lejuar shkrimtarë si M. Kraja, B. Blushi dhe M. Meksi të zhvillojnë një angazhim më të nuancuar dhe kritik me historinë, duke sfiduar narrativat tradicionale dhe ofruar perspektiva të reja mbi identitetin kombëtar. Më tej, romani historik shqiptar ka provuar të jetë një mjet jetik për të shqyrtuar dhe riformuluar nocionet e identitetit dhe trashëgimisë brenda kontekstit shqiptar.

Nëpërmjet prizmit të fiksonit, këto romane lejojnë një dialog mes së shkuarës dhe së tashmes, duke mundësuar një rivlerësim të ngjarjeve dhe figurave historike në dritën e vlerave dhe kuptimeve bashkëkohore. Në përfundim, romani historik shqiptar zë një vend të veçantë brenda letërsisë evropiane, i karakterizuar nga përshtatja inovative e konventave të zhanrit për të trajtuar realitete specifike socio-politike dhe roli i tij në diskursin mbi identitetin kombëtar. Ky zhanër jo vetëm që pasuron skenën letrare evropiane, por gjithashtu kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në vetëkuptimin kulturor dhe historik të popullit shqiptar.

Referencat

- [1]. Auerbach, E. (2000). *Mimesis, Realismo nella letteratura occidentale* (Vol. II). Einaudi.
- [2]. De Groot, J. (2010). *The historical novel*. Routledge. (p. 46).
- [3]. Eco, U. (1997). *Gjashtë shetitje nëpër pyjet narrative* (B. Hoxha, Trans.). Shkup.
- [4]. Eco, U. (2005). “Pashënie” në Emri i trëndafilin (D. Omari, Trans.). Biblioteka Koha Ditore. (f. 474).
- [5]. Elsie, R. (1991). *Evolution and revolution in modern Albanian literature*. Retrieved from <http://www.elsie.de/pdf/articles/A1991Evol.pdf>
- [6]. Hamnett, B. (2011). *The historical novel in nineteenth century Europe*. Oxford University Press. (pp. 74-75).
- [7]. Hutcheon, L. (2013). *Poetika e postmodernizmit* (D. Topalli, Trans.). Shtëpia botuese OM. (f. 29-30).
- [8]. Jakllari, A. (2010). “Për një tipologji të romanit shqiptar”. Aktet e seminarit ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Prishtinë, Fakulteti i Filologjisë.
- [9]. Kadare, I. (2002). *Dialog me Alain Bosque* (Ed. IV). Onufri. (f.82-83).
- [10]. Kola, G. (1997). *Ndoc Nikaj dhe burimet e romanit shqip*. Apollonia. (f.77).
- [11]. Krasniqi, B. (1985). *Poetika e romanit historik shqiptar*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. (f. 23, 99).

- [12]. Kuçuku, B. (2010a). "Romani historik shqiptar". Ligjerata në kursin MND për Histori romani. Universiteti i Tiranës.
- [13]. Kuçuku, B. (2010b). Tragjizmi në kontekstin e një letërsie himnizuese. Parathënie në Vepra letrare 1 (B. Xhaferi, Ed.). Tiranë: Arbëria. (f.13-72).
- [14]. Lukács, G. (1983). The historical novel (H. Mitchell & S. Mitchell, Trans.). University of Nebraska Press. (Original work published 1937). (pp. 39, 97-112).
- [15]. Maynard, M. (1995). "Beyond the big three: the development of feminist theory into the Women's History Review". The Women's History Review, (pp. 4, 259–271)
- [16]. Nikaj, N. (1961). Shkodra e rrethume. Shtëpia e Botimeve "Naim Frashëri". (f. 96-97).
- [17]. Nikaj, N. (1918). Fejesa n'djep. Shkodër. (f. 126).
- [18]. Qosja, R. (1973). Periodizimi i letërsisë së re shqiptare. Gjurmime albanologjike, (Seria filologjike, III). Prishtinë. (f. 99).
- [19]. Welsh, A. (1962). The Hero of the Waverley Novels. Princeton University Press. (pp. 62-65).
- [20]. Wesseling, E. (1991). Writing history as a prophet: Postmodernist innovations of the historical novel. John Benjamin Publishing. (p. 47).
- [21]. The Albanian historical novel in the context of European literature